

DEPARTAMENTI I INFERMIERISË DHE FIZIOTERAPISË

Përgjegjëse e Departamentit: Ph.D. Xhejni BORSHI

PLANIFIKIMI I KËRKIMIT SHKENCOR PËR VITIN AKADEMIK 2017/2018

Të dhënat rreth veprimtarisë shkencore të kryera dhe të parashikuara nga Departamenti i Infermierisë dhe Fiziotherapisë për vitin akademik 2017-2018 si më poshtë vijon:

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE E ZHVILLUAR:

Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Infermierisë dhe Fiziotherapisë në bashkëpunim me Departamentin e Stomatologjisë, Departamentin e Farmacisë si pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Albanian University organizuan Kongresin e III^o Italo-Shqiptar me temë “*Patologia Orale e Cervico Facciale*”, me pjesëmarrje të Profesorëve shqiptarë dhe të Profesorëve të Universitetit të njohur Italian Universiteti i Aqilës, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që Albanian University ka me Universitete të huaja. Ky kongres u akreditua me 9 ECTS prane qendrës QKEV ne Tiranë. Kongresi u mbajt në Tiranë, më datë 29-30 Shtator 2017 në ambientet e Tirana

International Hotel & Conference Center në sallën e konferencave “Balsha”. Në këtë Kongres u prezantuan punime të mirfillta shkencore të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuar në librin e abstrakteve. Ky kongres e arriti më së miri qëllimin e tij, në njohjen me të rejtat më të fundit shkencore në Mjekësinë orale, duke i tejkaluar edhe kufijtë shkencorë në përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetës.

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE TË PARASHIKUARA:

* Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë planifikon të zhvillojë një Konferencë studentore në bashkëpunim me studentët e programeve të studimit, Infermieri, Fizioterapi në rang Fakulteti me pjesëmarrjen e pedagoqeve të disiplinave të ndryshme. Kjo konferencë parashikohet të mbahet nga periudha Shkurt-Maj 2018. Tematikat synojnë të vendosin në fokus rritjen e shkencore që ndeshen në të gjitha disiplinat e formimit profesional të Infermierit dhe Fizioterapistit.

* Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë planifikon të zhvillojë nga periudha Shkurt-Maj 2018, një konferencë në rang Departamenti me tematika aktuale në fushën e shëndetësisë, me pjesëmarrje të Profesorëve ekspertë të fushave të ndryshme të shëndetësisë dhe me një aktivitet të pasur kërkimor shkencor shqiptarë dhe të huaj.

* Si çdo vit akademik do të nxitet pjesëmarrja aktive e stafit akademik të Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në Konferenca Kombëtare e Ndërkombëtare, si dhe të publikimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit, duke vlerësuar kontributin e tyre në arritjet shkencore dhe në një kualifikim të mëtejshëm të stafit akademik në Albanian University.

* Për vitin akademik 2017-2018, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë planifikon të zhvillojë nga periudha Shkurt-Maj 2018, dy leksione të hapura me pjesëmarrjen e profsorëve Italian të Universiteteve partnere, të Universitetit te Barit “Aldo Moro” dhe Universitetit te Akuilës, Itali.